

Deklaratë

Unë i nënshkruari _____ pjestar i ekipit _____ me nënshkrimin e këtij dokumenti deklaroj se si anëtar, i ekipit _____ i licencuar pranë FSHB-së, do të zbatoj më përpikmëri, udhëzimet dhe masat e qeverisë shqiptare, për mbrojtje nga Covid19.

Duke nënshkruar këtë deklaratë, vërtetoj se jam në dijeni të udhëzimit për mbrojtje nga Covid19 dhe se kam pranuar dhe lexuar atë përpara nënshkrimit dhe konfirmoj se:

Me pjesmarrje në aktivitete të basketbollit, konfirmoj me vullnet dhe në bazë të vlerësimit tim të lirë, se për çdo çështje që ndërlidhet me pjesmarrjen time në këto aktivitete, nuk do të kërkoj asnjë përgjegjësi materiale, juridike apo të formave të tjera, nga FSHB.

Marr përsipër të testohem, 72 orë përpara fillimit të edicionit sportiv 2020-21. Mos testimi do të jetë masë ndaluese për pjesmarrje në ndeshje të basketbollit dhe çfarëdo aktiviteti që organizon FSHB.

Gjatë kohë së stërvitjes/ndeshjes, do të respektoj udhëzimet për mbajtjen e maskës, distancës fizike, përdorimit të mjeteve desinfektuese dhe çdo udhëzimi tjetër.

Para fillimit të stërvitjes/ndeshjes do të pranoj matjen e temperaturës, nga ekipi mjekësor, si dhe në rast se do të ndjej simptoma si: temperaturë, kollë, tështitje, dhimbje trupi, nuk do të paraqitem në stërvitje/ndeshje dhe do të njoftoj drejtuesit e ekipit dhe mjekët që na shoqërojnë.

Gjatë stërvitjes/ndeshjes, nuk do të përshëndetem me duar, përqafohem, dhe do të mbaj me vete artikuj ushqimorë. Nuk do të përdor, artikuj ndihmës profesionalë të përdorur, si fasha, kyçore, gjunjëza, këto në përfundim të përdorimit të tyre, do t'i hedh në koshin e mbeturinave, të vendosur në ambientet përkatëse. Nuk do të bashkohem me grupe të mëdha dhe do të kujdesem për higjienën personale.

Pas përfundimit të stërvitjes/ndeshjes do të mundohem të largohem sa më shpejt nga salla dhe ambientet e zhveshjes dhe nuk do të shkoj në aktivitete sociale.

Do të mundohem të shfrytëzoj transportin personal në të kundërt do të ruaj distancën gjatë transportit të përbashkët apo atij publik.

Deklaroj se do të ruhem dhe kujdesem për shëndetin tim, do të mundohem të ruaj edhe shëndetin e lojtarëve të ekipit, kundërshtarëve dhe personave të tjerë zyrtarë, gjatë gjithë aktivitetit të basketbollit, deri në kohën kur të gjitha udhëzimet dhe masat anti Covid19 janë në fuqi.

Emër/Mbiemër: _____

Data: _____

